



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË TRETË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 28.05.2020 (e Enjte) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, kryetari, nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu, si dhe këshilltarët e Kuvendit: Basri Sylejmani, Zejnepe Osmani, Valbona Haziri, Ramadan Deliu, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Taibe Ibrahim, Zekirja Zuka, Nijazi Isaku, Jakup Demiri, Sejdi Emini, Mirlinda Sadiku, Liridona Bislimi, Remzi Salihu, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Samet Idrizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Valentina Hasani, Vehbi Rama, Rasim Terziqi, Besim Ymeri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, Zyra Ligjore, Zyra për Barazi Gjinore, mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 27 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e tretë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes, nënkryetarin e Komunës, juve të respektuar këshilltar komunal, drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, mediat elektronike dhe të gjithë të tjerët që janë prezent. Para se të kalojmë te miratimi i rendit të ditës. Me lejoni t’i falënderoj të gjithë ata që kanë kontribuar në këtë situatë të pandemisë, shtabin emergjent, stafin mjekësor, drejtorët, këshilltarët komunal, Policinë e Kosovës, qytetarët e të gjithë ata që kanë kontribuar në këtë situatë të pandemisë. Para se të kalojmë në pyetjet dhe përgjigjen, ju njoftoj, se konfirmimin e akteve të nxjerra nga Kuvendi Komunal i Vitisë, Zyra Ligjore e MAPL-së, e kanë konfirmuar vetëm për disa vendime. Dhe kërkoj që të gjithë ata të cilët nuk e kanë plotësuar formularin për deklarimin e pasurisë, është mirë që tani t’i plotësojnë dhe t’i dorëzojnë tek sekretaria e Kuvendit.

z.Hasan Aliu: Nënkyetari i komunës: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Ju uroj për rikthim në seanca të rregullta edhe pse në situatën e pandemisë i kishim dy seanca, po megjithatë puna juaj dhe kontributi i juaj në kohën e pandemisë ishte i pakontestueshëm. Arsyeja pse dola këtu është, sepse në mbledhjen e KPF-së, doktoresha Idajete Pira e ka ngrit një çështje për të cilën unë nuk e kisha informatën lidhur me mantillat të cilën e ka ngrit doktoresha dhe unë kam tani informacionet e plota dhe tani ta njoftoj, 123 mantilla kanë kushtuar 10 euro, jo ka 20 euro si e ki shtrua ti në KPF, që shumica e tyre është 1230 euro. Në atë pako kanë qenë 50 jelek që kanë kushtuar 15 euro, që shumica e tyre është 750 euro, dhe janë 40 uniforma të cilat kanë kushtuar 18 euro, që shumica e tyre kap 750 euro dhe në total të tre artikujt janë 2700 euro. Këtë e pata si informacion, sepse në përfundim të mbledhjes së KPF-së, këshilltarja ka shtrua si çështje dhe ke brendgose edhe për mua ai çmim. Po megjithatë kur i morra të dhënat, janë këto.

z.Idajete Pira: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kërkesë dhe nevojë e qytetarëve të Pozharanit dhe vendbanimeve të tjera, është fillimi i trotuarit aty ku ka mbete në rrugën Pozharan-Viti, të rregullohet të vazhdon deri në hymje të Vitisë. Po kërkesë tjetër dhe nevojë shumë e madhe është edhe ndërtimi i trotuarit te rruga “Zeqë Pira, Pozharan-Qifllak-Terpeze që është shume e nevojshme. Me sa kam informata unë, ata meritojnë, sepse është një numër i madhe i banorëve dikun Pozharani ka dikun 8 mijë banorë, Tërpeza dikun rreth 3500 banorë qifllaki i ka dikun për rreth 200 banor. Këta banorë të gjithë paguajnë tatime. Nuk do me thanë që tatimet ju kthehen në para, mirëpo duhet të ndërtohet në infrastrukturë të tyre, është mëse e domosdoshëm. Arsyeja pse duhet, është se të gjitha qytetarët aty më së pari kanë siguri personale për fëmijët si dhe për shërbime shëndetësore, se çdo informatë në mjekësi është, se ecja është shpëtim i shëndetit, po në këto rrugë është e nevojshme të vendoset edhe shportat e mbeturinave në shtyllat elektrike, për arsye se çdo shtëpi sa unë kam informatë ka kontonjera, mirëpo janë të detyruar t’i mbajnë në oborre për shkak qenve endacak, se sikur t’i lanë në rrugë, atëherë do të kemi infeksione të paparapame. Kam edhe një kërkesë tjetër, elektrifikimi në rrugën “Ram Avdyli”, një ditë punon, 29 ditë tjera nuk punon. Ju kisha lut ti shqyrtoni këto kërkesa.

z.Mirlinda Sadiku: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Kam kërkesë prej fshatrave, të sh.Skifteraj, derisa po vija në Viti, anësorja që është tek ura Skifteraj-Verbovc është shumë e dëmtuar dhe ajo paraqet rrezik, sidomos në kohën e natës, anipse janë vendos shiritat vrojtues, edhe pse është zonë administrative e Komunës së Kllokotit. Keni komunikim ju, do të kisha pas dëshirë, që kjo çështje të adresohet. Pyetje tjetër e kam, tek lagja “Shabani” në fshatin Skifteraj, është ndërru rrjeti i rrymës, mirëpo trafo nuk ka hy ende në funksion që tre muaj, këtë sapo e konfirmova me një përfaqësues të asaj lagjes dhe personi në fjalë merret me blegtori dhe shumë herë ka probleme me qumësht dhe shumë herë ju ka prish qumështi për shkak se cilësia e ulët e rrymës. Do të ishte mirë që ta adresoni këtë çështje, që të merret parasysh dhe të kryhet kjo punë.

z.Taulant Haxhiu: Përshëndetje të nderur të pranishëm! Unë para disa dite e kam dhënë një intervistë për Plus Tv, për pakon që janë nda për familjet me nevojë, ofertues të tjerë nuk keni pranë, e keni pas vetëm një ofertues dhe ai u kanë një biznes individual, NTP “BURIMI”. Diskriminim ju ka bë bizneseve enormë, bizneseve të Vitisë, “Emicenter”, “Mediteron”, Modeli, të njëjtët artikuj i kanë pas më një çmim shumë më të volitshëm, 45 euro, kurse përfituesi nga Prishtina, “Burimi”, ju ka dhënë oferta me të njëjtat artikuj esencial, me 53 euro e 95 cent. Kemi dikun diferencë 8 euro e 95 cent në pako. 1500 pako janë 13 mijë e 425 euro, që kanë qenë çmimi më i shtrejtë në krahasim me kompanitë lokale, kjo është një diskriminim edhe në këto kohë pandemie, shefi i prokurimit z.Fadil Abazi, së bashku më Sokol Halitin edhe këtu kanë bë një vjedhje 9 euro, i kanë dhënë më shume një kompanie “Burimi”, e cila është e panjohur. Unë punoj më biznes, dhe këtë kompani asnjëherë nuk e kam ndëgju. z.Pira e z.Vehbi Rama merren me biznes, e dinë këta sa kushtojnë ato artikuj esencial. Kjo është një marre që e keni bë në këtë kohë pandemie, nuk është Komuna e Vitisë e Fadil Abazit, e as e Sokol Halitit, është e qytetarëve të Vitisë. Duhet me dhënë përgjegjësi për këto pako, për këtë shumë që e keni 9 euro në pak ka qenë më e shtrej se sa që oferta e kompanive të Komunës së Vitisë. A ka mundësi mu përgjigje 53 euro e 95 cent, ka qenë oferta e kompanisë që e ka fitu “Burimi”, ndërsa kompanitë e Vitisë kanë dhënë këtë ofertë, 45 euro. Po ta kishim pas këtë ofertë nga bizneset tona lokale, kishim përfitu plotë, është 298 pako, kjo është një diskriminim, besoj që këta persona unë sot i kisha shpall hajnin kryesor të Komunës së Vitisë, shefin e prokurimit që i ka dhanë këto tender, z.Fadil Abazi.

z.Sejdi Emiri: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë sot i kam disa pyetje. Po filloj me projektin e ujësjellësit, me gypin e asbesit në Letnic-Viti. Është një projekt ku ka fillu në vitin 2017. Deri ku ka shku ky projekt dhe pse po vonohen punimet? Duam ta dimë këtë përgjigje ne si kuvend po edhe qytetarët e Komunës së Vitisë. Në vitin 2017, në fshatin Letnicë në afërsi të fabrikës së ujit, ka fillu punimi për gypin e asbesit, gyp ky që është vleresu i rrezikshëm për shëndetin e qytetarëve të komunës sonë. Vlera e këtij projekti ka qenë mbi 400 e 55 mije euro. Ai projekt është në bashkëpunim me CDI-në dhe i Komunës së Vitisë. D.m.th gypin ka pas me pagu CDI-ja, kurse punimet Komuna e Vitisë. Kam bë një pyetje me herët, po e përsëris edhe sot. Aparati i radiologjisë në shtëpinë e shëndetit ne komunën tonë, aparat i cili është donacion ngadikun në vlerë 25 mije euro, që shërben për të bë ultrazërin dhe në shërbim të qytetarëve të komunës sonë. Prapë po e thamë, qytetarët e komunës sonë detyrohen të shkoj t’i kryen

shërbimet në komuna tjera, e neve donacioni të cilin e kemi përfitu na flen, na rrinë jo në shërbim. Në seancën e kalume e votuam një donacion nga emiratet e bashkuara, ambulanten e Terpezes, mirëpo u tha që është mirë të votohet. E kemi votu të gjithë asamblistët. Është shumë mirë që arrihet mu përfitu ky donacion, mirëpo e kemi një ambulant e cila ka met si gërmadh në fsh Goshicë dhe nuk është në shërbim të qytetarëve dhe banorëve të fshatit tonë. Unë kërkoj që ky donacion që është i ndamë dikun në vlerë mbi 20 mije euro, të adresohet dhe të rinovohet ambulanta e fshatit Goshicë, sepse ashtu kështu është kanë donacion i ndërtimit të një amulance, vetëm të barten mjetet, pas i ky donacion është përfitu. Kemi edhe një problem në fsh. Goshicë, dikun që 5-6 herë bien dele të ngordhura në rrugën ku qytetarët e hecin çdo ditë tash vazhdimisht. E dine edhe drejtoria e din edhe bashkëfshatarët, është bë e patolerueshme, drejtroi i Inspeksionit, ju lutem në emër të banorëve të fshatit, që të merrni masa, keni qen të njoftuar edhe ju, ju duhet me ditë kush ka dele dhe kush po i bënë këtë dëmë qytetarëve. Është e patolerueshme!

z.Bekim Azizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Zyra e Informimit edhe në faqe të komunës e qet debatet e kryetarit, që i ka në nivelin politik me parti tjera ne Rubikon. Kjo është keqpërdorim i informatës që e jep, sepse në faqen e komunës qiten punët e komunës. Në faqe të komunës nuk qiten debatet politike që bëhen në nivel të vendit, në nivel të partive politike, d.m.th kjo është një keqpërdorim që Zyra e Informimit. Singërisht po thamë, me reagimet që është tu i bë, me informatat që po i qet, është shpeshherë duke e keqpërdor detyrën që e ka për informimin e qytetarëve. Sot edhe në KPF e kam bisdeu, e kam një propozim, konkret, nuk e di drejtori i Shërbimeve Publike a ka mujt me diskutu, që janë obligimet te kompania e mbeturinave të ujësjellësit, që shumë biznese për tre muaj nuk kanë funksionu, ndërsa obligimet do t'i kenë për ata tre muaj. Unë mendoj që duhet të merret një vendim ose duhet të bisedohet me ato kompani, që këto biznese që nuk e kane shfrytëzu ujin, pagesën e mbeturinave, sepse me siguri janë mbi 1000 biznese që nuk kanë funksionu këto tre muaj. Ndoshta duhet të bisedohet edhe me KEDS-sin, sepse vinë faturat fikse, se edhe aty duhet me punu, aty ku ka ndikim komuna duhet të bisedohet dhe të lirohen të gjitha këto që ngarkohen. E kam edhe një pyetje, meqenëse masat lehtësuese prej sot fillojnë, fillon qarkullimi i lëvizjes, grumbullimi deri 5000 vet ka të drejtë, ndërsa dy vet nuk kemi drejt me pi kafe. E dimë që prej sotit hapen xhamiat, kishat. A është bë dezinfektimi i tyre. E dimë që tash edhe nëpër shkolla kanë fillu, tash duhet ta di a behet dezinfektimi i këtyre objekteve.

z.Remzi Salihu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë kam pyetje për drejtorin e Financave. Siç e dini, temë diskutimi ka qenë herën e kalume asfaltimi i rrugës Skifteraj-Stubell e Ultë dhe për këtë unë pyes drejtorin e financave, cilat kompani janë të kontraktume nga komuna dhe çfarë raporti ka dorëzuar ajo kompani, dhe a është marr ndonjë masë ndaj kësaj kompanie? Nëse ajo ka pru ndonjë raport të rrejtshëm, sepse gjendjen e dimë, nuk po e diskutoj hiq. Pyetja e dytë është për kryetarin e komunës, rreth vendimit për emërimin, riemërimin e rrugëve, shesheve në Komunën e Vitië. Çka është vepruar deri me tani në këtë drejtim? Ka qytetar që me kanë pyet rreth kësaj, po edhe personalisht mu me duhet ta di.

znj.Liridona Bislimi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Edhe unë kam të njëjtën vërejtje që e pat Bekim Azizi, rreth publikimit të debatit të kryetarit në wëp të Komunës së Vitisë. Ne e dimë se qytetarët e Komunës së Vitisë ne wëp të komunës marrin informacione që ndodhin ne Komunën e Vitisë. Cila ka qenë arsyeja, që nëse kryetari shkon në një emision për tema nacionale dhe ai emision të jepet në wëp të Komunës së Vitisë? Çka kanë pas interes qytetarët e Vitisë me e ndegju atë emision përmes wëp të komunës zyrtare? Pyetje tjetër kame për rrugën e pa rregulluar në fshatin Mjak. Janë bë tash ma gati 20 vite që Komuna e Vitisë e ka lënë këtë rrugë të pa rregulluar, edhe pse rruga është shtru me zhavorr, ajo përsëri dëmtohet. D.m.th, kur e ka plan komuna me e bë shtrimin e kësaj rruge. Pyetje tjetër rreth stadiumit në Pozharan. A është e vërtet që janë nda 200 mije euro për ndërtimin e këtij stadiumi, dhe nëse po, pse nuk kanë fillu ende punimet?

z.Ali Bajrami: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kam pyetje për drejtorin e Financave. E di që është koha, që të fillon punimi e Kornizes afatmesme buxhetore dhe buxheti për vitin e ardhshëm, janë obligative debatet me qytetar, prandaj kisha pyetje, si do të mbahen këtë here, sepse shkaku i pandemisë do të këtë edhe vështirësi. Pyetje tjetër për drejtorin e Shërbimeve Publike. Është bë punë e madhe në dezinfektimin dhe deklorizimin e shume objekteve dhe shume rrugë në vija të trasha. Kisha kërku prej drejtorit të ja jep një shpjegim për punët që janë bë. Gjithashtu në këtë

kohe që ka qenë në teren Drejtoria e Inspeksionit, në krye me inspektorët, që kanë bërë një punë shumë të mirë gjatë pandemisë. Kisha kërku prej drejtorit, të na jep një shpjegim lidhur me menaxhimin e situatës së pandemisë.

z.Vehbi Rama: Përshëndetje për të gjithë! Unë kërkoj, sepse janë anku disa banor në rrugën “Rexhep Bislimi”, që është rregullu kanalizimi. Fatkeqësisht është dëmtu trotuari aty. E dimë të gjithë, kanë qenë edhe këshilltarët komunal prezent, fatkeqësisht është dëmtu aty. Pyetja tjetër, pse ambulanta në fshatin Zhiti është e gatshme, ku do vetëm riparim e nuk fillon. Vitin e kalum kemi qenë në Zhiti, ka qenë prezent edhe nënkryetari dhe e kanë bërë këtë kërkesë, që aty gravitojnë tri fshatra: Kravarica, Ballanca, Zhitia. Sa i përket situatës që e kemi aktuale, pandemia, e falënderoj shtabin emergjent që ka qenë për shpërndarjen e ndihmave, ka qenë një komision prej partive politike, ndër ta kam qenë edhe unë, edhe kisha kërku nga drejtori, që ka ende pako me naj bërë një raport, ndërsa sa i përket pakove që e tha edhe kolegu, pse këtë nuk e fitoj një kompani në Viti po një në Prishtinë. Kjo është fatkeqësi që të gjithë, jo vetëm na që punojmë në biznes, që i dimë çmimet, po e dini edhe popullata, sepse çdo ditë ushqehen, se ato janë gjana ushqimore, i dimë çmimet. Si do që të jetë, edhe në qato çmime është dashtë me marr një kompani nga Viti, se kur po është nevoja e çdo partie politike, po kërkojnë votë në Viti e jo në Prishtinë, të jemi më lokalista.

z.Ekrem Abazi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Ata çka pata me thanë me gjerësisht, u tha nga Sejda. Unë pasi që jetoj në atë pjesë e njoftoj Sejden, që gypat që një vit e tepër kanë përfunduar, po e kame përmend shpesh. Ndoshta çdo punë që përmendet shpesh, behet edhe bajat. Nëse unë e kam bërë bajat që kam pyet shpesh, ju e keni bërë bajat që nuk keni dhënë përgjigje konkrete. Qysh unë e di, paret janë pagu, ju kanë pagu punëkryesit edhe CDI-ia i ka dhënë ato paret e veta. Po pyes, pse qytetarët tonë nuk furnizohen me gypat e ri që janë vendosur që një vit e tepër. E dini gjithmonë, që përpara janë thanë çdo ditë, që gypat janë kancerogjen, tash askush nuk bisedon për ta. Kjo është përgjegjësi e dikujt, nuk jam në dijeni unë qind për qind, ama me sa jam në dijeni, kjo është përgjegjësi totale e përgjegjësve, e inxhinierave tonë të komunës edhe punëkryesi që e ka kry, po ai paret i ka marr.

z.Hasan Aliu Nënkryetar i komunës: I kemi drejtorët prezent, të cilët do të përgjigjen në pyetje, ndërsa pyetje që ju adresuan kryetarit të komunës, do të përgjigjem unë për ato të cilat kam shënime. Duhet të dimi, se çdo kryetari i komunës që është në pushtet dhe që e ushtron detyrën e vet, ai e ka pas një program të vetin, të cilin është obligativ me e realizu, për shkak që kërkon ju dhe qytetarët dhe shumë çështje të tjera që mundën të dalin jashtë saj. Kërkesat e qytetarëve mund të hinë, po megjithatë nuk kërkon kumeditë çfarë përgjegjshmërie ndaj kryetarit, për shkak se ai ka fitu me një program tjetër, këtë po e thamë. U shtrun dy çështje nga këshilltarja, për trotuare. Tash nuk muj saktë me ditë a janë në programin e kryetarit edhe trotuari për Terezë, nuk po thamë që nuk është i nevojshëm, dhe trotuar prej Urës së Kurteshi në Viti, këtë nuk e di a është, por e di që është premtim i kryetarit çerdhja dhe e di që ajo ka mu realizu, dhe tani nëse mundet me e tejkalu ai çështjen e premtimeve, pse mos të jenë edhe ato, por megjithatë duhet t'i shikojmë, se kërkesa mund të kemi plotë, por përgjegjësia e kryetarit është lidhur me programin e vet, me të cilin i ka fitu zgjedhjet. E dinë ti këshilltare, aty tek ura, aty e frekuentojnë shumë qytetar, edhe të skifterajt, stubllasit, remnikasit dhe do të shikoj mundësinë, nëse nuk ka mundësi ata ta bëjnë sikur që e kemi bërë asfaltimin e asaj ure, do ta bëjmë edhe rregullimin, në mënyrë që t'i mbrojmë qytetarët tonë. Çështjen tjetër, presion të madh kemi bërë rreth trafos, por megjithatë do ta kemi mirëkuptimin e kompanisë private për shkak pandemisë, presionin do ta bëjmë të vazhdueshëm, ti e dinë që kompetencë me e obligu nuk kemi. E di që ata qytetar kanë qenë keq, keq sa i përket rrymës dhe kërkesa e tyre, po tash masi jemi në këtë fazë, besoj që kemi me mrrë edhe finalizimin, që ta kenë një rrymë standarte. Taulant, tash e ki shefin e Zyrës së Prokurimit këtu, ai përgjigjet. Po ajo që deshta me thanë, ai titullimi yt në adresë të kryetarit, duhet të ndërpritet. Pse nuk jam avokat, kryetari i komunës ka pas një vullnet të mirë dhe ka ardh me një propozim para juve, që e keni pas edhe ju vullnetin e shkëlqyeshëm, e keni miratu një vendim me 100 mijë euro. Obligimi i kryetarit të komunës, është me i than udhëhiqi procedurat në aspekt ligjor. Detyrë e zyrës është me i udhëheq, kryetari kontrollon ligjshmërinë, dhe këtë e ka bërë, dhe ti nëse ki ato dyshime të tjera që po i shtron këtu jashtë kësaj, janë do zyre atje në Gjilan, të Prokurorisë, vetëm qoe atje, jam për me ndjek, të jetë edhe vëllau im apo të jem unë, jam për me ndjek, po megjithatë duhet të rumi nga ai fjalor që është shumë i ranë, deri sa për të njëjtin nuk e kemi argumentin e kundërt. Gypi i ujësjellësit i cili u shtrua si çështje nga dy këshilltarët, e di që para dy jave kanë dal në testim të gypit dhe nuk i ka pru pompat të cilat në aspekt profesional bëhen dhe e di që sot janë tu e bërë që mujmë me dal ne me e shiku, por

megjithatë kanë dal edhe para dy jave ku inxhinierat profesional, kanë thanë jo me e leshu ujin, se nuk e tregon çka janë ato në aspektin inxhinjerik. Atë forcën se sa do ta ketë mbajtjen e shtypjes dhe kane kërkru edhe pompa, konsideroj që sot nga ora 8 janë në vend të ngjarjes. Te aparati i radiologjisë, është aparat i cili është funksional, në rast që e ki fjalën për ultrazë, së shpejti do të aktivizohet edhe ai me rastin e pranimit të një gjinekologe apo gjinekolog, aparati është funksional. Këtë informatë e marr tani drejtpërdrejt nga QKMF-ja. Çështja e propozimit të Sejdes, besoj që në rishqyrtim të buxheti muj me e shiku atë ridestinimin e atyre mjeteve. U shtru një çështje, se në wep të komunës tash varet ai zyrtari ka mujt nëse është bë ai lëshim. Unë nuk po e kontestoj, ndoshta ka mujt me bë, tu e ditë se ky është kryetar komune. Në rast se e marrim në kontestin se u kanë përfaqësues i një subjekti politik, në atë rast ka mbrojt interesat e një subjekti politik, edhe unë jam që me korrigju dhe mos mu bë asi lëshime. Obligimet ndaj bizneseve, ti shikojmë Bekim tash këto pakot e nivelit qendror, kanë me qenë që ende janë të pazbërthya. Të shiqojmë cilat janë masat që mund t'i lehtësojnë ato të cilat ne kemi pas ndikimin, e kemi aprovu edhe ju, edhe e kanë shpall të ligjshëm. Tash këto tjerat duhet t'i shikojmë krejt a janë në harmoni me aspektin qeveritar, ajo që është shpenzu duhet të paguhet. E tek çështja e dezinfektimit, e di që asnjë xhami e kish nuk do të lejohet të hapet pa dezinfektu, edhe për shkolla është e njëjta rregull. Çështja e rrugës së Stubllës, edhe sot një javë u ngrit kjo çështje. Kam bë përpjekje ta gjej kush ka qenë menaxher dhe i kam kërkru një dokument, me shkrim ma ka sjell, ai që e kam këtu sot. Operator ekonomik, ka qenë "Arlindi" SHPK nga Ferizaji, dhe me ka interesu shkresa e tij që ju ka drejtu dhe operatori ekonomik që e ka kthye thotë: "e ka riparua pjesët e dëmtuara të rrugës Skifteraj-Stubell". Riparimi është bë nga operatori ekonomik në kushtet e garancionit që ka ofrua për punimet e kryera. Menaxher ose mbikëqyrës i kësaj, ka qenë Rafiz Shabiu dhe thotë: sërisht asfaltimi i rrugës Skifteraj-Stubell e Poshtme, ende vazhdon të mbetet në fazën e garancinë që operatori ekonomik ka ofruar për punimet e kryera ne këtë rrugë. Edhe Liridona e pat të njëjtin shqetësim, "Rruga e Mjakut", shtrimi i saj. Kryetari para pak dite me ministrin e Infrastrukturës e ka nënshkrua një memorandum, janë nda edhe 200 mije euro, jo për "Rrugën e Mjakut", ta kemi të kjartë, është rruga që kap prej këtu të shkolla që vitin e kalum e kemi shtrua një pjesë të asaj, vlera e projektit ka qen dikun 3 milion euro, prej këtu, që del dikun në Komunën e Kaçanikut ka Hani i Elezit. Po megjithatë është projekt i ministrisë, dhe mjetet po i lëshojnë ata pjesë pjese, sivjet i kemi 200 mije euro të cilin do të udhëheqim procedurat. Në mesin e këtij projekti ka edhe ankesë të rrugëve dhe në mesin e tyre është edhe "Mjaku". Tash sa do të marrim me ato 200 mije euro, nuk po guxoj me të thanë kurgja, se nuk po e di sa e mrrimë, varet nga operatorët. E vërtet është, stadiumi në Pozharan është bë presion, ata vetëm kanë fillu, po jo në atë stazen e dëshiruar edhe tonën edhe të juajën dhe unë besoj që ajo çështje do të fillon me ritëm dhe do të punohet për vlerën të cilën e ka. Alia shtroj çështjen e dëgjimeve publike, po është e vërtet, unë konsideroj që konformë rregullave nga IKSHP-ja, ne do t'i bëjmë, ndoshta në rast që vazhdojmë në këto raste, pse mos të organizohet një takim më qytetar i formës së tillë që e kemi sot këtu. Vehbi, ajo që është dëmtua, besoj që do ta detyrojmë kompaninë, që trotuarin ta kthej në gjendje në të cilën u kane në këto ditë, jo vetëm për rrugën e Stubllës, po edhe shumë kompani të cilat ndoshta kemi leshu vendime që t'i kthejnë në gjendjen që kanë qenë para se me u punu. Tek çështja e ambulancës në Zhiti, aty me pëlqeve se ke hi në kompetenca të tejkalimit të kufijve administrativ, e përfshive edhe Kravaricen, nuk na lejon Gjilani këtë, po megjithatë jam për aktivizim të ambulancën. Po shkojmë gradualisht tu i aktivizua të gjitha amulantat. Për pyetjet tjera, ju përgjigjen drejtorët që janë prezent këtu.

z.Basri Aliu Drejtor: Përhëndetje të nderuar të pranishëm! Po ju përgjigjem pyetjeve të parashtruara. Sa i përket aparatit për ultrazë, ne kur e kemi marr si donacion e kemi pas mjekun e radiologjisë i cili ka punu aty, e ndërkohë e ka lirua vendin e punës dhe ka shku dikun tjetër me punu. Po ne sipas udhëzimit administrative 8/2017, që e rregullon sistemin shëndetësorë dhe e organizon, ne jemi në përgatitje, e kemi vetëm mjekësinë familjare, sigurisht edhe mjeket janë, këtu e elaborojnë këtë, prandaj ne nuk kemi të drejtë të marrim specializant, po vetëm ata që i kemi prezent. Kështu, ndërkohë është tu shqyrtu kjo herë pas here, edhe ultrazëri. I kemi dy mjektë që punojnë dikun, tash në shtator e kemi në specializim një gjenikologe, e cila pritët ta kry specializimin e të kthehet në repartin e gjinekologjisë, prandaj ai do të jet funksional dhe do të shfrytëzohet prej shtatorit, ndërsa të ambulanca e Gushices, e di që edhe dëshira e jonë është me pas çdo kund ambulancë, po kanjëherë, mundësitë nuk po janë. Besoj që shpejt do të rregullohet edhe ambulanca në Gushicë, ndërsa për donacione jemi në pritje, po deri sa nuk kemi marr informatë në atë kuptimin

zyrtarisht, na e kemi pjesën tjetër, me njërin do të vazhdojmë me ambulanten në Terpezë, ndërsa Vehbia e bëni pyetjen për Zhiti. Janë disa defekte aty në ambulant, për të cilën nuk kemi dashtë ta hapim pa e rregullu ato. Besoj që shumë shpejt do të funksionalizohet edhe ne Zhiti.

z.Skender Ahmeti drejtor: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Ishin dy pyetje për drejtorin e Inspeksionit. Sejda, i cili ngriti shqetësimin për delet e ngordhura, që po hedhen për rreth rrugës Germov-Goshicë, disa herë jam marr me atë rast, jam dal edhe vet ne vend të ngjarjes, kemi qenë me bashkëpunëtor, kemi terjek kafshët e ngordhura në shumë raste kane intervenu edhe policia edhe prokuroria. Ka kerku prej neve me marr masa, na kemi marr çdoherë masa, i kemi eliminu në mënyrë me të mirë të mundshme, po për këtë dukuri kaq të rand, ne kemi kërku bashkëpunim nga policia po edhe nga qytetaret e Gushices, kemi kërku që të përcjellët se kush po i hudh ato kafshë të ngordhura. Nuk kemi mundësi ne si inspektor me i identifiku, sepse kafshëve të ngordhura po ju heket numri identifikues nga veshët, kështuqë nuk po kemi mundësi me ditë nga kush po vinë ato. Pyetja tjetër ishte nga Ali Bajrami, që tregoj për punën që e kemi bë si drejtori, kemi qenë që nga 13 Marsi për çdo dite në pune jemi marr me të gjitha rastet, i kemi përfill të gjitha rekomandimet e institutit të shëndetit publik, kemi respektuar të gjitha vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë, kemi pas një bashkëpunim të shkëlqyeshëm me komandantin e policisë, që e falënderoj publikisht dhe bashkëpunëtorët e tij 100%, e kemi pas bashkëpunimin maksimal me ta, po edhe qytetarët i falënderoj se i kanë respektu ato masat ne rastet kur janë tejkalu këto masa edhe ka pas shkelje të masave të cilat janë parapa me sëmundjen infektive. Kemi proceduar procedurat kundërvajtëse administrative, në disa raste dhe jemi duke vazhduar edhe me tutje. Me keqardhje e thamë këtë, që duhet me i respektu ligjet që janë në fuqi dhe vendimet e Ministrisë se Shëndetësisë dhe për këtë janë disa raste që janë sanksione me të larta, po duhet t'i aprovojmë dhe pas ndëshkimit administrativ, nëse nuk shqiptohet dhe nuk respektohen e nuk paguhen këto gjopa, atëherë lënda shkon në procedurë gjyqësore dhe ndëshkimi do të jetë edhe më i rendë.

z.Nexhmedin Jakupi, drejtor: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! U ngritën disa shqetësime. Këshilltarja Mirlinda i bëri pyetje për dezinfektimin e kësaj kohe të pandemisë, pra, na që nga formimi i komitetit dhe nga 13 marsi kemi fillu edhe me dezinfektimin edhe me klorifikimin e atyre rrugëve nëpër qytet, sidomos me klorifikimin me zjarrefiksat që i falënderoj për angazhimin që e kanë bë gjatë kësaj kohe. Dezinfektimi është bë në të gjitha objektet komunale arsimore, shëndetësore dhe në objekte shtetërore, tu fillu nga stacioni i policisë, gjykata, disa herë janë përsërit dezinfektimi në disa objekte dhe rreth objekteve hapësirave ku kemi pas raste të prekura nga ky virus, si në fshatra Pozharan-Smirë-Ramjan-Stubell-Viti. Tek objekti banesor, këtu afër komunës, disa herë kemi intervenu me dezinfektim dhe jemi në përfundim të dezinfektimit, tu i përjashtu dy tri fshatra që do të përfundojnë sot ose nesër. Rreth klorifikimit, kryesisht jemi marr në këto vende ku kemi pas të prekur nga Covidi dhe rrugët kryesore në qytet, ku kemi pas frekuentim më të madh të qytetarëve, me dezinfektim që nga 13 marsi. Ne atëherë nuk kishim kompani të kontraktuar për me bë dezinfektimin, po fal një kompanie, më doket nga Ferizaji, na ka dal në ndihmë dhe na ka dezinfektu vullnetarisht, si donacion, shume objekte dhe hapësira publike, tu fillu nga qendra e qytetit në park, QKMF, objektin e njësisë së zjarrfikëseve, shtabin emergjent, ku kemi qenë të vendosur. U ngrit edhe një çështje rreth ndriçimit publik të një lagje në Pozharan. Unë sot po e marr këtë informatë që ka probleme në at lagje me ndriçim publik. Zakonisht ne si drejtori e kemi një bashkëpunim shumë të mirë me kryetarët e këshillave të fshatrave dhe vazhdimisht prej tyre ose anëtarëve të këshillave të fshatrave kërkojmë informata, nëse kanë defekte rregullisht ata na informojnë për defekte të ndriçimit publik, edhe na kërkojmë prej kompanisë që e kemi të kontraktume me i riparua ato defekte. Do ta kem parasysh këtë problem. Mirlinda e ngriti një çështje rreth urës ne Verbovc. Ajo është në territorin e Komunës së Kllokotit. Kemi kërku nga Komuna e Kllokot që ta riparon atë defekt, aty ata nuk e kane rregullu deri më tani, na kemi me e rregullu me kompaninë e kontraktuar që e kemi me mirëmbajtje e rrugëve gjate Verës. Na ka pengu koha tani me shih, se pas intervenimit që e kemi pas në Skifteraj, besoj që shpejt do ta rregullojmë edhe këtë që e ngriti Mirlinda, Bekimi e ngriti, kemi bisedu rreth obligimeve që i kanë kompanitë apo subjektet afariste që punojnë ndaj “Ekohigjienës”. Unë kam bisedu me “Ekohigjienën”, ata me kanë thanë që një muaj nuk i kemi fakturat, po prej të gjitha atyre bizneseve, nuk paguajnë të gjitha ato biznese, pastaj edhe është çështje e tyre qysh i kanë kontratat.

z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! U fol në mjetet e informimit rreth pakos ushqimore, të cilën komuna e ka udhëheq procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Ajo procedurë është në rregull, sipas të gjitha rregullativave ligjore, mirëpo mund të jemi subjektiv dhe mund të themi gjithçka tu ngrit poteza qyshe ka mujt me qen ndryshe, mundet me qenë ndryshe sipas dikujt, po ndryshe nuk mundet me qenë përveç qeshtu qysh e kem udhëheq na. Unë e kam një raport shumë të detajuar, po mos ta lexoj, sepse ju marr kohe, po sipas shqetësimeve që u ngritën, unë po du me dal shume shumë korrekt dhe transparent para juve, me qëllim që të shuhet zërat subjektiv në këtë procedurë, e cila është udhëheq sipas nenit 35, pika 2, pika 3 e Ligjit të Prokurimit Publik. Njoftimi i KRPP-së, i datës 16.03.2020, i cili i zgjeron autoriteteve ta përdorin për shkak të situatës së pandemisë, ta përdorin këtë metodë e cila metodë të vetmin efekt e ka që shkon shpejt. Është e njëjtë me procedurat tjera, vetëm këtu afatet kohore janë të shkurta. Çështjen e ngritur rreth ofertave, është procedurë e negociuar, mirëpo shkon në faza, në fazën e parë pranohet tri oferta, pastaj autoriteti vazhdon me një ofertë e cila duhet të jete më e lira, dhe ne kemi vazhduar me ofertën më të lirë, e cila ka qenë operatori ekonomik “Burimi”. Unë e kam raportin që i kemi pranuar ofertat dhe kush do më shumë informata, ju kisha lut, Zyra e Prokurimit është e hapur, do të ju ofroj të gjithëve gjithçka për çka jeni të interesuar dhe çka mund të ju ofroj unë, dhe kam qef, që për shkak të punës time profesionale, të ju bindi juve, që kjo është ligjore, tu i përjashtu ato akuzat politike për të cilat nuk po du me hi hiq andej. Nëse ka shkelje ose keqpërdorim, është Zyra e Prokurimit, ku unë jam përgjegjës. Nëse ka dikush diçka që unë e kame shkel ligjin, urdhëroni, janë organet. Çështja rreth përzgjedhjes. Në momentin që bëjmë ne njoftimin në mjetet e informimit, ajo tendenca për me nda tregun, Kosova është treg unik, i pavarur, nuk ka ndarja regjionale, nuk ka Viti, Ferizaj, Prishtinë, po është një treg në të cilin operojnë operator, konkurrojnë, marrin tendera edhe i plotësojnë kushtet, sepse duhet të ketë kushte aty, të cilat duhet të plotësohen, sepse nuk mundesh me marr ti një ofertë prej një operatori, po supozojmë të Vitisë, i cili ndoshta kurrë nuk pagun TVSH-në. Institucioni jep një tender, dhe interesimi numër një që duhet ta kemi ne parasysh, është TVSH-ja, sepse shteti i jep para një pune, po do që TVSH ti kthehet p.sh. në 2 milion kontrata që kemi në Viti na, shteti përfiton 300 e diçka mijë euro TVSH. Prandaj, tendenca për thirrje për t'i nda operatoret në Viti ose dikun tjetër, edhe pse duket thirrje shume e mirë, unë e kisha pranuar edhe pse është kundërligjore. Nuk mujmë me shku ne përtej asaj. Unë kam tender të rregullt, po kurrë operatorët e Vitisë për ushqimore, prej vitit 2012, asnjë operator ekonomik nuk e ka vizitu zyrën, nuk ka hy, nuk ju ka interesu, megjithatë, unë viteve të mëhershëm edhe ju kemi qu fjalë, se ta keni të kuartë, Zyra e Prokurimit nuk guxon me thirr në tel operatorin e as nuk guxon me shku me e vizitu. Me qef edhe unë do të kisha than qysh po thuni ju, po tash puna u krye, jemi në rregull, nuk mund të kthehem mbrapa, jemi të bazuar në ligje, operatoret ekonomik që kane apliku vazhdimisht tek ne, kanë qenë në sistem dhe ata kane aplikua. Tashti është krejt transparent, kurgja nuk ka subjektive. Ne asgjë nuk shohim e dërgojmë një e-mail, e shpallim tenderin deri të vjen dita e hapjes, ti nuk sheh kurgja, kur behet hapja i shohim të interesuarit dhe i pranojmë dosjet. Shumë shtete të BE-së nuk kane E-prokurim, po Kosova ka avancu në këtë proces dhe mendoj që është shume mirë. Çmimet! Sa u përket çmimeve, tregu është relativ, ofertat ndryshojnë, sot e ki një çmim, nesër mundet me qenë tjetër. Për të qenë transparent me juve, me opinionin, për punën që e bëj unë, unë kam hulumtu tregun, edhe atë 40 dite pasi e kam lidh ofertën, ne muj, me marr ofertat nga kuponat fiskal para 20.04.2020 dhe mi shiku çmimet ku jemi kane, sepse krejt e dimë se çmimet kanë qen të fryme për pandemi, sepse kërkesa u rrit, pritshe në ren me marr një thes mill dhe pagujshe sa dojke ai vet. Unë i kam marr tri oferta pardje dhe i kam krahasu çmimet, mesataret janë nxjerr duke i marr ofertat, duke i përpjesëtu në mënyrë diskrete, pa ju tregu operatorëve në bizneset me të frekuentuara në Viti. Oferta mesatare e pakos me kupona fiskal 56.82, oferta me e lartë 58.86, oferta më e lirë 54.84, çka do të thotë kjo, edhe sot pas 40 dite na prapë jemi nën çmimin e ofertave të sotme në treg, na jemi nën çmimin që konsumojnë qytetarët e Komunës së Vitisë. Ata konsumojnë sot me qeto çmime që i kemi këtu, sa supozojmë ne ose sa mujmë na me godit, ajo nuk merret parasysh. Unë i kam marr 10 oferta të millit, sepse çmimi relevant është milli, sepse tjerat janë me pak të rëndësishme, i kame marr 10 oferta të millit nëpër shitore, më të lirën e kam gjetë 8.99, më e shtrejtja është 10.99. Tash ndërmjet tyre pako është me e lirë, është më lirë se sa tregu i Vitisë dhe ne mesatare jepet me lirë. Gjithçka që unë e kam këtu, është me e lirë. Unë i kame marr edhe çmimet për me qenë më transparent, p.sh.: që Orizi, fida i kam fotografu tri çmime të fides, e kame ble me të lirën, i kam fotografu tri çmime të makaronave, e

kam marr me të lirën, pasulin. Metodologjia e marrjes së çmimeve është metoda krahasimeve, çmimi i tregut është i lirë, prandaj po du me ju thanë nëse keni naj argument ose naj dyshim, janë organet, Zyra e Prokurimit jep përgjegjësi për këtë punë, për çmime jam në gjendje me i mbrojt kur të doni. At ditë që e dëshmoni të kundërtën e asaj që e thash, unë jap dorëheqje, e pranoj publikisht që kem gabu, sepse kush do që punon gabon, po me çështje subjektive, me tendenca, me goditje, jo.

z.Taulant Haxhiu: z.Abazi, unë dhe familja ime jetojmë prej biznesit. Sa i përket TVSH-së, kompania ime është e regjistrueme, është një nder tatimpaguesit me të mëdhaj në Komunën e Vitisë për vitin 2019. Kompanitë të cilat janë në Viti, janë shume me serioze dhe të gjitha janë kompani shume me të mëdhaja se sa kompania që e ke përzgjedh ti, NTP “Burimi”, vaji, kripa, sheqeri, që janë artikuj esencial, krejt na e dimi sa kushtoj. Nëse ti personalisht nuk e ki përzgjedh një përfitues 8.95 me shumë, më shtrejt që sa janë kanë çmimet reale, beso që Taulant Haxhiu nuk ka mu merr me politikë ma, asnjëherë. Asnjëherë nuk jam kanë më i sinqertë se sot. 8.95 ja ke dhënë tenderin një kompanie që ka qenë një kompani individuale. Unë po ta argumentoj, i lus kamerat që ta zmadhojnë pak këtë 45 euro, këtë çmim ma ka dhënë “Mediteran Grup”, me pronar Niko Dodaj, 44.50 cent, ma ka dhanë “Modeli” në Viti, me pronar Samet Rexhepin, këto çmime, ti mundesh me ardh bashkë me mu, për hirë të opinionit publik, se këto çmime janë kështu siç i sheh edhe ti, po ka njerëz këtu prezent, z.Pira dhe z.Vehbi Rama, unë i kam 32 vjet, e këta kaq vite i kane me tregti, këta e dinë që këto çmime janë ashtu qysh po thamë unë. Unë me qet punë punoj, jo me tjera, ti 8.95 e ki pagu një paket me shtrejtë, për ata të qujta dhe hajn, sepse e ki vjedh buxhetin e Komunës së Vitisë. Nënkrjetar, po të përgjigjem edhe ty. Kam reagu ndoshta pak edhe ashpër, po të ishe ti në vendin tim, e unë në vendin tan, edhe tash është Kurban Bajrami, dhe Komuna e Vitisë do me dhënë 300 kurbanave për familjet me nevojë, atëherë na e shkrujmë në tender, përfituesi i tenderit të kurbanave ka qenë 160 euro, atëherë edhe ti do të reagon si unë, sepse ti e dinë çmimin e një kurbanit sa është. Për atë unë kame reagu kështu, sepse i di çmimet.

z.Ekrem Abazi: Nënkrjetari sot naj dha një lajm të mirë për furnizimin e qytetarëve me ujë të pijes, prej gypave nga Letnica. Unë nuk jam ekspert i kësaj lëmie, po besoj që para nja 8 - 10 muajve, nuk e di sa u leshu uji në ata gypa, po ata gypa kane pelsit në katër pese vende me një sasi shume të vogël të ujit që janë leshu në ata gypa. D.m.th nuk ka fuqi ai me bart at ujë që ka nevojë për Vitinë, e qeto pumpat që thave tash, nuk e di çka janë, e masanej nuk e di çka është investu. Ju e dini se ku e kam shpinë tem, përmi shpi temë me një gyp u fornizu një pjese e Begunces. Me qata gypat e ri që kanë ardhë, një pjese e vogël e Begunces tash a janë tu formizu a jo nuk e di, po unë po e përsëris, për ata gypa duhet me siguri me e hek prapë e me bë punën ma të mirë, se nuk ka me pas suksese kjo punë, po shifet që punët po kryhen, po po bëhen shumë punë të dobëta, qytetaret dhe unë si qytetar dyshoj që ka pas korrupsion, ka pas hajdukni, ata njerëz kërkush nuk ka ardh me i kontrollu se çka po behet me ata gypa, apsolut, se e kam shpinë qaty dhe kam dal shpeshherë kam bisedu me punëtorë, i kam pyet, a ka ardh dikush me ju keshyr. Kurr, hiq kurr ata zall të imtë nuk kanë qit mbi ata gypa, absolut. D.m.th nuk ka me pas suksese kjo iniciativë që ka fillu, d.m.th shumica e tyre e dimë që nuk ka me pas suksese. Sa i përket këtyre ndihmave që janë dhënë, unë përveç sasisë duhet edhe cilësia. Burra, kanë shpërnda ndihma boll, po cilësia e millit që e ka shpërnda komuna, nuk e di a u kanë grek apo i serbisë. Qëndroj pas kësaj, bisedoni me qytetarët që kanë marr, nuk ka mundësi ai mill mu bë bukë kurrsesi nuk pjekët edhe ne 250 gradë temperatura. D.m.th edhe furrat janë në nxorr prej atij milli. E pyeta një furragji, çka po bëni me këtë mill. Tha, duhet me i qit 10 thasë tani me qit një qasi me e mbulu krejt qytetarët që e kane marr at mill, nuk kanë mujt me e shfrytëzu, po e kanë qu tek furra. Për mu, si pushteti lokal ashtu edhe ai qendror, ata njerëz qe vjedhin, ata që korruptohen, që kanë bë pasuri prej politikës, për mu ata njerëz janë kriminela, si pushteti komunal si ai qendror që janë pasunu në korriz të qytetarëve. Unë më së shumti në bot i urrej bashkëpunëtorët e Serbisë dhe njëjtë janë edhe këta që e vjedhin vendin.

z.Vehbi Rama: Unë ju përgjigjem nënkryetarit. mos këshyr kanë ta injoroj, se kërkush nuk tha që me kanë kufizohet. Thave Kravarica nuk është në Komunë të Vitisë. Unë e di që banorët e fshatit kanë thanë, që një pjesë e Kravaricës shkon e bën kontrollin në Viti, apo në fshatin Zhiti, sepse është afër gjeografikisht. Si p.sh.: ta marrmi Zllatarin, Dardani, janë me Ferizaj, po këta kontrollin e bëjnë në Pozharan. Nuk e kanë të kufizuar, ti fort mirë e njeft tregun e paraluftës, ke pas të drejt prej Remniku me shku me shit në Gjilan, Ferizaj. Sa i përket tenderit të pakos, unë

e thash në fillim, merrem me biznes, nuk thash as që është fallcifiku, po thash që çmimet kanë qenë të shtrejta. Pasuli me pakicë sillet dikun 2 euro, ose 2.5, fidja dikune 0.50 deri 0.60 cent, e milli, na kemi qen donator 8.5 thesi i millit është marr në Viti, edhe çka është më interesant, ndryshe është dy tonë e gjysmë, ndryshe 3000 thasë, ka dallim në çmim. Tjetra, kur tha Ekremi, është e vërtet që cilësia ka dallim, cilësia e millit.

z.Samet Idrizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë pa anime politike do ta jep kontributin tim për procedurën që është shfrytëzuar në kohën e pandemisë. Realisht këto procedura nuk shfrytëzohen në rrethana normale, po na e dimë që ka qenë gjendja qyshe ka qenë. Sa i përket udhëheqjes së procedurës, mund të jete gjithçka në rregull në aspektin ligjor, mirëpo kjo procedurë është pikërisht procedurë që mundesh me të Pazar, kjo procedurë nuk është publike, kjo procedurë nuk ka njoftim, e dine këtë edhe Fadili. Ligji ta mundëson vetëm një operator me e thirr edhe me e mbyll punën. Ki të drejtë, vetëm një operator negocion, e negocimin me e kthy në gjuhen popullore, d.m.th Pazar, bile në ligj thotë: “zyrtari i prokurimit, bashkë me zyrtarin kryesor administrativ”, që i bien kryetari apo nënkryetari, që mundet me qen prezent, ulen dhe në bazë paramases së artikujve që ofrohen edhe bën Pazar. Tash zyrtari i prokurimit nuk mundet me ju than, ti ki mi pru 70 mije, se ai nuk hin me e demtu veten, mirëpo kryesorja me ja harmonizu çmimin. Zyrtari i Prokurimit lun një rol tejet aktiv në përcaktimin e çmimit dhe cilësisë së mallit. Ajo çka mua me ka brengos, kuptohet që tregu është unik në Kosove, çmimin nuk muj me e paragjyku, a është real a po jo. Në aspektin moral, Fadili ka qenë dashtë me qenë më i vëmendshëm, sidomos në këtë kohë, nëse në Viti nuk ka pas firma qysh tha Fadili, që mos mu kanë të regjistrueme në E-prokurim, e që Fadili nuk mundet me i kontraktu, procedura zhvillohet përveç ftesës që ja bën ti përmes numrit fiskal, apo numrit unik. Në këtë mënyrë ti e fton. Ligji ta mundëson, kanë të do me e ftu. Ky ka muj me e ftu një firmë, p.sh.: të Gjilanit, Vitisë, Kamenicës e jo me shku në Prishtinë, pse ka shku në Prishtinë nuk eshte shkelje ligjore, a në aspektin moral unë e kisha fajësu Fadilin, sepse ka qenë dashur të jete me i vëmendshëm, ta kontaktoj një formë të regjionit tone.

z.Njazi Isaku: Përshëndetje të nderuar koleg! Në mbledhjen e kalume e kemi diskutu, që në këtë mbledhje me pas një raport nga Zyra e Prokurimit dhe me e diskutu, e ky zyrtari i prokurimi naj shpalosi në pika të shkurta raportin. Sameti e elaboroj shume mirë në aspektin ligjor çështjen e procedurës. Kjo nuk është procedurë e rregullt dhe ne si asmble, asnjëherë nuk kemi ngrit një problem të prokurimit se qyshe i marrin tenderët, përveç që asnjë nuk e kmi besu, se besoj që është zyra që nuk i besojnë as qytetaret, as asamblastët asaj zyre, për shkak, se krejt rrethanat dhe krejt punët që kryhen i shohim pasojat pas një viti dhe nuk qëndrojnë, ndërsa në këtë kohe pandemie ne si kuvend komunal dhe si komunë, kemi nda mjete 100 mije euro për me ju dal në ndihmë qytetarëve dhe me e shfrytëzua këtë rrethanë. Kjo është për mu skandaloze, për arsyeje se tu ka dhënë mundësia, ofroj mundësinë qytetarëve tonë, që bizneset tona në Viti le ta marrin, besoj që edhe këto biznese tona i kishin dhënë një çmim edhe me të lirë dhe kishin përfitu qytetarët, sa me shume pako ushqimore. Në këto rrethana me shku me marr në Prishtinë, edhe Sameti e tregoj që na e dimi që është tregu i lirë dhe nuk mundem me ja ndalu kërkuj, po në këto rrethana ti e ki pas mundësin me ja dergu kërkesën kompanive të Vitisë dhe besoj që kishin hi me çmim edhe me të lirë dhe për këtë pjesa dërmuese e këshilltarëve e kemi ngrit këtë çështje, se këtu është një keqpërdorim, qysh mundet prej Prishtinës ai me ardh me derivat e me krejt me ardh me lirë këtu në Viti. Besoj që e kishit marr çmimin me të lirë ne Viti. E unë mendoj që këtu edhe kryetari po edhe nënkryetari duhet me reagu, duhet me marr masa. Unë e di që se ke shkel ligjin, ama në aspektin moral ka qenë dashur me i njoftu bizneset e Vitisë.

z.Rasim Terziqi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë punoj në tregëti siç punojnë disa koleg. Këtu prezantimi i fakteve nga Fadil Abazi nuk mjafton, ngase unë konsideroj që ato foto që i ka bënë ai, ato nuk janë fakte, sepse është fotografu një artikuj që është vlere, ose në pandemi që është vlere 1.09 cent supozojmë orizi, mirëpo kur të llogaritet si pako, duhesh me bënë kërkesën për një pako, që ma merr mendja që del si pako me lirë nja 20 deri 30%, se marketet normal që fitojnë, e ti po naj sjell neve foto qyshe kushton një artikuj. Realisht në depo tek unë, me ardh me kerku një kofe fasad, nëse kushton 15 euro, po nëse ai e bënë një ofertë, p.sh.: për 50 kofe, unë muj me ja dhënë edhe me 12 euro. Menjëherë është vlere me e vogël. E tha Sameti, mund të behet pazar për me e kursy buxhetin e komunës, ta lejon edhe ligji, këtu ju nuk keni bënë Pazar, ja keni dhënë kompanisë “Burimi”, e tash ki dal ki bënë foto sa kushton një oriz. Unë besoj që ki mujt me dal me ofertë më të lirë, me e kursy buxhetin e komunës.

z.Remzi Salihu: Pyetjen ja drejtova drejtorit të financave, e përgjigjen ma dha nënkryetari. Faleminderit nënkryetar, mirëpo, unë pyetjen e kam bërë kështu: Cila kompani është e kontraktuar nga Komuna e Vitisë për të treguar cilësinë e asfaltit, kurse nënkryetari ma dha emirin e kompanisë ekonomike. E di që komisioni për pranim teknik është në përbërje prej tre anëtarëve, dhe ka konstatuar, se kryerja e punëve është bërë sipas standardëve dhe cilësisë së duhur. Krejt në rregull, mirëpo mu po më intereson emri i kësaj kompanie që merret me cilësinë e asfaltit dhe ndoshta do të interesohem të bëj pyetje në këtë kompani, se çfarë mendimi ka dhënë ajo kompani për cilësinë e asfaltit. Kurse për pyetjen e dytë komisioni për emërimin e rrugëve, nuk e di se kush është, nuk e di, me siguri ende nuk është emri i kryesuesit, atëherë unë kërkoj nga përgjegjësit të merren me këtë komision, sepse nuk shkon kështu de fakto marrim vendime, ndërsa ato vendime nuk zbatohen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Rreth komisionit për emërimin e rrugëve, komisioni që është formuar nga kuvendi komunal. Është çështje, se ne si kuvend e kemi themeluar këtë komision. I mbetet komisioni mu funksionalizuar dhe t'i shqyrtojnë kërkesat që janë nga qytetarët.

z.Sejdi Emiri: Jam me se i sigurt, që edhe asamblistët e LDK-së këtë pako 100 mijë euro nuk e kishin votuar me qef, me pas ditë që këto i shkojnë dikujt në Prishtinë, apo jashtë Vitisë. Besoj që pajtoheni edhe ju. Ujësja ka filluar në vitin 2017, nënkryetari tha që janë tu punuar që dy javë, po i presim deri në seancën e radhës ta shohim apo e zgjedhim problemin. Aparati, u mundat që të bindeni që aparati punon. Na e dimë që aparati është i ri, po nuk është funksional, aparati është në qese, i ri, po nuk ka njeri që punon me ta. Ambulanca, tash qaj donacion që është i ndarë për Terpezë, vetëm le të bartet me të njëjtin qëllim në shëndetësi. Kafshët e ngordhura, mos prit qytetarët me dal atje me tu bërë polic. Unë nuk e di pse po ja lë këtë përgjegjësi qytetarit, ku qytetari kërkon që tre katër muaj që i hedhin këto kafshë të ngordhura në rrugë. Ju po thuani që qytetarët duhet me njoftu ju, a po doni ngatërresa tek qytetarët, a ju e dini që tre katër fermer janë që mbajnë kafshë.

z.Basri Aliu drejtor: Sejdi, sigurisht edhe ti po e shfrytëzon kohën e pandemisë me bërë fushatë. Unë kesh i kjo me udhëzimin administrativ 8/2017 mbi organizimin e shëndetësisë primare, nuk parashihet radiolog, prandaj ne nuk kemi mundësi të marrim radiolog. Aparati kohe pas kohe shfrytëzohet, se i kemi dy mjek të cilët e shfrytëzojnë, të cilët e kanë kry për ultrazë dhe ata janë duke e shfrytëzuar aty ku ka nevojë, plus pritet që tani për fat të mirë që e kemi në specializim doktorësh për gjinekologji, prandaj ai kur të kthehet në shtator do të jetë shumë funksional.

z.Ali Bajrami: Unë kesh shumë racional në diskutimin e mëhershëm, po parafolësit thanë shumë gjëra. Ajo që më shtyri me dal, është që, u parastrofu grupi parlamentar i LDK-së. Kur e kemi votuar këtë pako, kemi qenë të njëzërit të gjithë asamblistët për çka kemi votuar, ka qenë mjetet, shuma që ka qenë prej 100 mijë euro, procedurat i ka ndjek tjetërkush e jo si asamblist, po aq më pak na si grup parlamentar i LDK-së. Në emër të grupit e kërkoj mendimin nga Zyra Ligjore, sa i përket mënyrës së procedurës, a ka pas shkelje ligjore apo nuk ka pas.

z.Ramadan Deliu: Përshëndetej të nderuar të pranishëm! Unë më së pari du me i falënderu stafin emergjent, sjarrfiksat, policinë, stafin shëndetësor, administratorët e fshatrave që kanë punuar në këtë kohë, e sa i përket kësaj pakos që po flitet për ta, unë tash me dal me këshyrë rrake pa afat, muj me gjete pak edhe me 20 euro. Duhet me këshyr pak edhe cilësinë se çka ka pas aty. Ki sugjok 1 euro e gjysmë, ki sugjok 3 euro, 4 euro e 5 euro. Tash po e marr lapsin e qato që kanë qenë në paket me 20 euro, ti bi unë me afat të skadum. Duhet me këshyrë pak edhe cilësinë. E sa i përket Prishtinës, Prishtina nuk është në Serbi edhe ajo është Kosovë. Ka qenë me i liri e ka fitu tenderin. E kemi shtëpinë e kulturës, ambulancën, komunën atje, tek Presidenca. Krejt këto që i kanë punuar janë kanë kompanitë e Vitisë, po gjithmonë kur e ka marr tenderin, dikush kanë thanë pse ja dha atij.

z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit: Sa i përket pyetjes së Remzi Salihut, operatori ekonomik që e bënë matjen e testit të asfaltit është IMN Test Beton nga Ferizaji, ndërsa sa u përket të tjerave, asnjë moment nuk e rrezojnë punën që e ka Zyra e Prokurimit dhe duhet të shikojmë rrethanat e tanishme dhe të atëhershëm kur e kemi hapë, nuk janë të njëjta, nuk kemi pas mundësi atëherë me dal me hulumtu, kemi punuar në gjendej emergjente, prandaj duhet të kuptohet ajo sot gjithçka është ndryshe ama për kohën që e kemi kry në rrethanat të caktuara nuk ka mujtë më mirë dhe kurrkush sun e kish kry më mirë.

z.Hasan Aliu nënkryetar: Unë konsideroj se vetëm ata të cilët mujn me keqkuptu apo deshten me i shtremu çështjet me detyrim, me dal sërisht reagimet e dhënë si pozitë e si opozitë të mijat ato të cilat i ka përcjell dikushe në politik, gjithherë kam konsiderim dhe konsideroj se ka pas keqpërdorim, kanë qenë shumë tash do të jen, po ajo që dalloj unë se ai ne jetën time nuk e ka përkrahjen derisa për këtë e konstatoj një procedurë gjyqësore, apo procedurë tjetër, disiplinore, që mun me e shkakto. Unë njohës i mirë i kësaj çështje nuk jam, po megjithatë edhe unë jetoj në Kosovë të Vitisë dhe përafërsisht jam obligativ ti referohem institucioneve të cilët apo zyrtarëve që janë përgjegjëse për atë punë dhe e marrin përgjegjësinë për atë çështje. Në rast se e kemi një zyre e cila thotë, se gjithçka është në rregull dhe e kemi një konstatim nga Zyra Ligjore që është obligative në mëngjes në takimet me kryetarin dhe nënkryetarin në aspektin ligjor, është në rregull. Unë shkoj në hapa të mëtutjeshëm, një këshilltar me tha që unë e injorova. Nuk është në domenin tim, kurrë në jetë nuk e kamë injoru kërkan, as ty apo kërkan dhe me të tregu që Kravarica e ka më afër Cernices, apat po të tregoj dhe nuk vjen kurrë në Zhiti. U fol për pako, Fadili e arsyetoj nëse dhe në aspektin ligjor të koka në rregull, nëse ju keni dyshime, tjera që ku është prokuria unë vij me juve në rast se konstatoj që ka shkelje. Raport për ndihma u ngrit, natyrisht që ka ende pako institucionale të pa shpërndara, ato duhet mu shpërnda. Jo rasisht me propozimin e kryetarit kemi thanë, dy këshilltar le të jen nga opozita ne shpërndarjen e ndihmave. Propozimi i juaj u kanë i vullnetit më të mirë të mundshëm me shku për nevojtar. U tha a keni marr masën ndaj shefit te prokurimi. Jo, sepse aspekti ligjor na tregon që ai është në rregull. Kur të merr masa Hasan Alia dhe Sokol Haliti, mane ne mend, nuk ka gjykatë tani që e kthen, i marr krejt faktet, e nuk jemi si do që vendosim sot e mas një jave ma ja kthy në punë. Më fal Remzi për keqkuptim, po e morre përgjigjen.

znj.Albulena Haxhiu zyra ligjore: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Fillimisht sa i përket procedurës, totalisht është ligjore, është e plotë, është në harmoni me dispozitat ligjore, është neni 35, paragrafi 2 i Ligjit të Prokurimit Publik. Realisht kjo është një procedurë e negociuar, e cila ndodh në raste të jashtëzakonshme, jo në suazat e rregullta. ky është aspekti ligjor, është në harmoni me të gjitha ligjet pozitive të Republikës së Kosovës.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje për të gjithë! Është fol shumë për këtë pako. Po e dimë që aspekti ligjor të koka në rregull, po këtu nuk është punë ligji, se këto farë procedurat mirë janë, po këtu po mungon morali.

Kryesuesi z.Naim Pira: Ju faleminderit të gjithëve. Tani po kalojmë tek rendi i ditës.

R e n d d i t e

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dyte e Kuvendi Komunal.**
- 2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2020.**
- 3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e draft strategjisë komunale kundër dhunës në familje për vitin 2020-2023, si dhe planin e veprimit.**
- 4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e draft rregullores për transparencë në Komunën e Vitisë, me kërkesën e MAPL-së.**
- 5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik të planit komunal i menaxhimit të mbeturinave.**
- 6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik të rregullores për menaxhimin e mbeturinave.**
- 7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik të planit komunal i veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021.**
- 8. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit te punës se komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuar për vitin 2020, dhe raporti i punës për vitin 2019.**
- 9. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit te punës se komitetit për Arsim, Kultur, Rini dhe Sport për vitin 2020.**

Kryesuesi z.Naim Pira: A ka dikush rrethe rendit të ditës ju lutëm? Konstatoj se me vota unanime miratohet rendi i ditës.

Pika e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e KK-së.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat rreth procesverbalit. A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim? E hedh në votim procesverbalin. Me votat e të gjithëve u miratua procesverbali.

Pika e dytë e rendit të ditës:

2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2020

z.Ibrahim Rama drejtor: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Si zakonisht nuk është hera e parë që Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, bazë ligjit që e përcakton, duhet t'i paraqet para kuvendit komunal pasqyrat financiare për ekzekutimin e buxhetit e Komunës së Vitisë, e kemi fjalën për pasqyrat financiare janar-mars të vitit 2020 në përgjithësi. Ju materialin e keni marr kohe dhe e keni konsultu. Ky raport apo më mirë me thanë pasqyrat financiare drejtpërdrejt paraqesin ekzekutimin e buxhetit të miratuar në Vitin e kaluar nga ju, prej 1 janar deri në 31 mars. Zakonisht të gjithë jeni të informuar në këtë situatë kemi qen kemi kerku edhe si qeveri komunale dhe si Drejtori për Financa të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me ekzekutimin e buxhetit me një mënyrë me shume a po me pak kanë qen të kufizuara për hir të covid 19 kështu edhe pasqyrat financiare në kuptimin ligjor janë në rregull po në kuptimin e realizimit të planifikuar të buxhetit nuk e kanë plotësua performancën për të cilën kemi plaifiku me qen me nivel me të lart po kryesish buxheti i ekzekutuar ka ndodhe në këtë formë si vijon nga 3 milion e 411 euro të alukuara gjatë këtyre tre muaj janë shpenzu 2 milion e 119 euro a po shprehur në përqindje 62.12%, pagat dhe mëditjet nuk kemi pas kufizime janë ekzekutu me kohe dhe me rregulle ekzekutimi i këtyre jane 99.94%, shërbimet dhe mallrat 25.49%, komunalit 39.54%, subvencionet 44.07% dhe investimet kapitale 3.33% arsyeje tjetër që kanë ndodhe këtu përqindje kanë qen se buxheti nuk ka qen i miratuar deri në fund të Marsit kështu që zakonisht Ministria e Financave përmes vendimeve të kuvendit çdo muaj ka marr vendim me e aluku një pjese 1 të 12 të buxhetit të vitit të kaluar për këtë buxhet edhe mjetet financiare kemi pas mungesë deri në fund kur është miratua buxheti po kryesisht ne në komunë nuk e kemi lan pa e ekzekutua të gjitha ato obligime që i kemi pas të parapamë, materialin e keni marr me kohe për pyetjet shitesë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat rreth pikave të prezantuar nga drejtori.

z. Ali Bajrami: Përshëndetje! Faleminderit drejtor për shpjegimin e pasqyrave financiare për periudhën tremujore janar-mars 2020. Është një punë që ka ngecë, po dijen rrethanat dhe shkaqet. Na mbetet një përkushtim, një angazhim. Dashtë Zoti që edhe masat lehtësuese që kanë fillu të aplikohen, të fillojnë të jeken të gjitha, që qytetarët të jenë të lirë, bizneset të fillojnë të operojnë. Me fillimin e bizneseve që nuk janë duke punuar, me siguri do të rritet edhe inkasimi i të hyrave vetanake, që kanë diku direkt, që kemi edhe tek tatimi në pronë, kemi ramje të të hyrave. Edhe Drejtorin e Urbanizmit, se e dimë që sektori i ndërtimtarisë nuk ka punu. Çka deshta me cek këtu. Te kodi 13630 furnizime mjekësore. Nëse ke mundësi me i shpjegu, tek përqindje e shpenzimeve sillen aty 60-70%. Nuk po i përmendi të gjitha. Ajo çka më ra në sy në këto pasqyra, se në periudhën tremujore të vitit 2020, me krahasu me tremujoren e vitit 2019, kemi shpenzime dikun 51 mijë e 518 euro më pak.

znj.Mirlinda Sadiku: Drejtori e elaboroj. Nëse ka mundësi në seancën e qershorit, vendimet gjyqësore me naj pru, nëse ke mundësi ashtu njëjtë siç naj ke pru vitin e kaluar, kame pyethe konkrete sa po e konfirmova tani në wep zyrtare të komunës kemi pas hap konkurs me 14.11.2019 për bursa të studenteve ata kurr hala nuk i kanë marr ato bursa, ma merr mendja që nuk është e drejtë, sepse shumë kush ka llogarit në ato pare kanë qen në vitin 2019 në fund vitit besoj që ka pas mundësi me i pagu. Pyetje konkrete kam: a ke bë një analizë, p.sh.: a do të kemi suficit? Po nisem p.sh.: tek udhëtimet që janë brenda vendit. Aty llogaritet bartja e fëmijëve. Tash e dimë që shkollat nuk funksionojnë prej 13 marsit, atëherë normal ato pare nuk shpenzohen një far forme të imponohet me pas suficit një kompani nga Deçani, kuvendi komunal, vetëm ja ka dhënë dritën e gjelbër, me para të komunës e kanë kontraktu një kompani me bë një hulumtim në aspektin ekonomik. Sa do të jetë ndikimi në buxhetin komunal, ju a keni mendu në këtë drejtim, sepse me njëfarë forme, direkt kur të vjen koha të planifikimi i buxhetit i kornizës afatmesme buxhetore, ne jemi cunguar. Nuk e dimë përafërsisht sa ka me qenë impakti i gjithë kësaj periudhe që kanë kalu bizneset private, kur e

dimë që pagun taksa, TVSH e të gjitha, prandaj do të ishte si sugjerim, ju jeni ekonomist, e dini më mirë. Tek shpenzimet kapitale janë përfshi vetëm dy projekte, janë 3.33, i keni dikun 46 mijë e 651 euro që kanë qenë të planifikuara, janë me minus. Çka ja merr mendja drejtor, krejt këto impakte, d.m.th mëtutjeshëm kemi një ramje totale të donacioneve, çka nuk është mirë. Dhe tek subvencionet në bujqësi, ani pse ka qenë Covi 19, bujqit, fermerët, asnjëherë nuk janë ndal, çoftë në Debolle, Skifteraj e gjithandej, prandaj pse kemi një analizim kaq të ultë të subvencioneve, kemi pas mungesë të buxhetit, që nuk është aluku, apo ku ka qenë problemi si dhe të shërbimet e ndryshme shëndetësore, sikur se kolegu Ali që e ceku, kemi dyfishim prej 12 mijëve 24 mijë. Këto pajisje shëndetësore, a kanë të bëjnë, a kanë të bëjnë që është dash mu furnizu me maska me dorëza apo, se ka shifet një dyfishim, prej 12 mijëve në 24 mijë. Dhe të pajisjet tjera janë shifrat e njëjtë sikurse në vitin 2019, ashtu edhe në vitin 2020, nuk ka variu shumë.

z.Bekim Azizi: Tu e pas parasysh rrethanat e buxhetit në tremujorin miratimin e buxhetit në nivel të vendit, që është miratu në muajin mars, problemet me pandeminë, që tre muaj kemi qenë pjesë e izolimit. I dimi problemet, e dimë që nuk ka pas mundësi dhe për këtë do të jem shumë i shkurt. Unë edhe në KPF kam thanë që raporti për 6-mujor duhet të jete me i kompletuar, sepse na mungon një rubrikë e diferencave të pagesave për vitin e kaluar. Mendoj që duhet të na vjen, mendoj që edhe raporti i 6-mujorit nuk do të ketë mundësi të diskutohet shume, për shkak specifikave që ka, mirë po megjithatë do të ketë diçka mundësi. Unë për sot tek vendimet e gjykatave, i përmendi Mirlinda, ndoshta naj jep naj sqarim dhe po me intereson kodi 14230, shpenzimet e informimit publik 3800 euro. Është një vlerë e madhe për këta tremujor, a janë obligime të mëhershme. Po një pyetje tjetër, keni pas të pranume punëtor me kontrata me shërbime të veçanta, na i dimi që janë shit shërbimet e veçanta. Në këtë kohe të pandemisë taman ja ka nis me punu, i ka ra dy tre muaj me ndejtë në shpi, e ka kontratën për tre muj deri sa të ja fillon punën i bën tre muj a është pagu. Ai për këto tre muaj apo keni marr ndonjë vendim tjetër, që këto shërbim mi kry, pasi të fillon procesi normal i punës i është veprim te këto raste. Te qasja në dokumente zyrtare, që tre muaj e kemi bë një kërkesë për do dokumente që ju është drejtu juve drejtor, Zyrës së Prokurimit dhe Zyrës së Informimit. Asnjëherë një informatë nuk e keni sjell, e kemi pas parasysh edhe rrethanat që kane qenë, nuk kanë mujt mu zbatu 7 ditë, mirëpo megjithatë tre muj dit me zgjatë kjo është shumë. Mendoj që duhet me qenë më te kujdesshëm ju.

znj. Idajete Pira: Tek shërbimet kontraktuese të tjera. Këto i kam nxjerr tek shpenzimet e Zyrës së Kryetarit, shpenzimet e administratës së personelit, shpenzimet buxhet e financa, shpenzimet publike, shpenzimet shëndetësi. Po filloj tek shpenzimet në Zyrën e Kryetarit, shërbimet kontraktuese tjera 7116 euro e 7 cent, është kodi 13460 mu me ka bë shume përshtypje pse mos mu cek qdo shpenzim që jane kontraktu mu specifiku edhe tek shpenzimet e administratës dhe personelit, me të njëjtin kod janë shërbimet kontraktuese 3100 euro, tek shpenzimet buxheti dhe financa, shpenzimet kontraktuese të tjera të njëjtin kod janë 1217 euro e 6 cent. Tek shërbimet publike, pajisje tjera 10 mijë e 710 euro, me kod 13509, pse mos mu specifiku këto me i sjell faturat të vulosura. Shërbimet shëndetësore të ndryshe në shëndetësi, edhe pse e dimë që në shëndetësi ka shërbime ndoshta edhe të pa para nganjëherë dalin, janë 24 mijë e 450 euro po edhe tek këto, kërkoj me pru fatura dhe me dit çka është ble dhe ku kane shku ato.

z.Remzi Salihu: Tek Zyra e Kryetari, me qenë se Mirlinda e ceku punën e shpenzimeve dhe vendimeve gjyqësore, të cilin ja kërkojnë drejtorit të financave, që t'i sjell në seancën e radhës. Po unë po bëhem pak i padurueshme, deri atëherë po e bëj tani një pyetje: si është e mundshme nga totali për shërbime dhe mallra që është gjithsej 24 mijë e 874 euro e 25 cent? Gjithsej nga këto mjete të jenë shpenzime të vendimeve dhe gjykatave 10 mijë e 920 euro e 72 cent, nëse mundet dikush nga administrata apo nga drejtori i financave të naj jep një shpjegim, a është kryetari ai që është në faj a po varësit e tij, apo ndoshta mos është edhe ndonjë dënim në këtë kohe pandemie, sepse si shpesh e ka përgoju IPKSH-në.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Po filloj nga pyetja e fundit për vendimet gjyqësore, 99% kanë të bëjnë me pagat në arsim, me pagat jubilarë, pjesa dërmuese e këtyre vendimeve, edhe pse jemi në dijeni informacione se është tu prit në ren një numër i madhe i lendeve për ekzekutim nga organet e gjyqësisë, vendimet tjera që janë kompetent ose kemi qenë neglizhencë në Drejtorinë e Financave, për mosrespektim të pagesave ligjore, nuk kemi as nuk kemi pas. Këto vendime janë të gjitha nga e kaluara, që buxheti nuk është parapa, përveç për vitin 2019-20 jeni në dijeni që kemi të

drejt mi pagu të gjitha pagat që janë të parapamë me kontratë kolektive, ndërsa deri në vitin 2019 ato nuk i kemi pas mjetet financiare. Pagesa është një problem tjetër. Departamenti i thesarit në Ministrinë e Financave në të shumtën e rasteve nuk na konsulton, se ku mi marr mjetet na nuk i kemi të planifikuar në buxhet ato mjete e ata naj marrin ku të dojn ata ka njëherë naj marrin bashkë, ku nuk kemi qef na, kurse për vendimet tjera të specifikuara në pasqyrat e radhës janar- qershor, do të jav sjellin në mënyrë të specifikuara, kurse disa kërkesa që i bëni doktoresha Hid, që kanë të bëjnë me shërbimet kontraktuese, këto pjesa dërmuese i këtyre shërbimeve kontraktuese janë në vlerë, pra siç është cek 20 mije e 499 euro janë kontrata për punëtor për shërbime të veçanta, 364 euro janë pagesa të komisioneve të ndryshme dhe asgjësimi i mbeturinave në shëndetësi është 3663 euro. Kryesisht pra mbi 85% janë kontrata me shërbime të veçanta, tash pagesa e këtyre kontratave apo punëtorëve, a është legjitime në aspektin ligjor, kur nënshkruhet kontrata për një punëtor për shërbime të veçanta, ai konsiderohet punëtor pe rate periodhe i rregullt dhe nuk kemi të drejtë nëse nuk dodhë naj arsye ligjore, apo naj keqpërdorim i detyrës zyrtare për me e largu, me ja ndërpre kontratën. Me ligj jemi të obliguar, të gjithë ata qe kane kontrata me shërbime të veçanta, me ja pagu pagat të cilat i kanë parapa me këto kontrata. Pra, në këtë drejtim nuk guxojmë me bë shkelje ligjore, sepse ata e fitojnë me ligj, kurse ardhja në pune a kanë ardh apo nuk kanë ardh, ju e dini një pjesë e tyre kane ardh një pjesë nuk ka ardh, kjo ka qen një planifikim i komunës, komunale i gjithë stafi nuk ka ardh në pune kemi punu me staf të rekrutuar. Ishte një pyetje për bursat e studenteve. Po vitin e kaluar ka qenë konkursi për bursa. Unë e di që komisioni është formu në kuadër të Drejtorisë së Arsimit, është në fund të përpilimit të listës përfundimtare, komisioni nuk ka punu nuk ka qenë aktiv. Unë besoj që tash së shpejti ka me perfundu lista dhe kemi me fillu me bë pagesën, përndryshe ky është obligim ligjor. Një pyetje ishte, suficiti buxhetor. Këtë vit suficiti sigurisht nuk kemi me pas, deficit muj me pas, se kemi mungesë të financave, përndryshe unë jam ithtar edhe në kuptimin profesional, po jo ligjor, se komuna në përgjithësi në aspektin ekonomik shumë herë deficitet janë hecjet përpara, kurse suficitet më shume shpjegohen si neglizhencë apo planifikim jo i drejt i te hyrave, që kanë të bëjnë me buxhetin, subvencionet në bujqësi ishte një pyetje. Zakonisht kategoria e subvencioneve subvencionohet nga kategoria e të hyrave që i grumbullon Komuna e Vitisë, nuk financon niveli qendror të gjitha subvencionet. Kemi pas ngecje në të hyra vetanake dhe në planifikim, për përmbushjen e obligimeve të subvencioneve në bujqësi edhe pse bë bazë të kërkesave që i kemi të planifikuara, Drejtoria e Bujqësisë, unë e kam arrit qëllimi që me javë siguria mjetet për të gjitha ato obligime që i kanë pas për subvencionet për bujqit. Ju e dini para pak ditësh ka ndodhe edhe një shpërndarje e subvencioneve të Drejtoria e Bujqësisë, kjo ka qenë kërkesë që mjetet janë plotësua saktë. Sa ka pas nevojë të implementohet ky projekt.

Drejtori z.Basri Aliu: Drejtoresha bën pyetje lidhur me shërbimet e ndryshëm shëndetësore, se këto shërbime janë për një kontratë të cilën ne kemi me Karitas Kosovën dhe punëtorët të cilët punojnë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe me programe të tjera që punojnë, pra këto shpenzime janë për këta punëtorë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, ju falënderoj për kontributin e dhënë.

Si pikë të tret të rendit të ditës kemi:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e draft strategjisë komunale kundër dhunës në familje për vitin 2020-2023, si dhe planin e veprimit.

znj.Ibadete Hyseni, zyrtare për barazi gjinore: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Në hartimin e këtij akti, jemi fokusuar në tri komponentë: parandalim, mbrojtje dhe riintegrim të viktimave të dhunës në familje. Janë përcaktu katër objektiva strategjike dhe shumë objektiva specifike, të cilat janë zbrëthyer në aktivitete që kanë të bëjnë me parandalimin e dhunës në familje dhe rinteigrimin e viktimave të dhunës. Pasi që e kemi marr materialin me kohë, për pyetje shtesë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesisu z.Naim Pira; Hapi debat për këtë pikë.

znj.Mirlinda Sadiku: Gjatë pandemisë, dhuna në familje është në rritje. E kam një pyetje konkrete. Ne kemi pas strategji edhe mëherët, sa jeni e knaqt me implementimin e asaj strategjie a ka pas rezultat dhe cilat janë përvojat që i kemi marr prej asaj strategjie, cilat janë sfidat që do të përballemi në momentin që po ka mungesë të buxhetit. Kjo po

mbetet vetëm në letër, ndoshta këtu tek neni 3 është bërë një lëshim me 06.01.2020, është bërë debate publik, po është një gabim. Më intereson ta di kryetari, e ka potencu shpeshherë edhe në bazë udhëzimit administrativ, me sa e kam lexu, strehimoret regjionale duhet të përkrahen me proporcion me numrin e viktimave që vinë nga ajo komunë. A është mbështet strehimorja, nuk e di sa është numri. Bisedova një ditë me policët që janë përgjegjës, ma konfirmuan se është në rritje numri i rasteve, nëse e keni këtë përgjigje mirë.

z.Nuredin Luftiu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kam disa vërejtje sa i përket kësaj strategjie. Në faqen nr. 6, është eliminimi I pabarazisë gjinore, kjo nuk mundet me ekzistencën si term tek dhuna në familje. Mundet me qenë strategjia komunale për parandalimin e pabarazisë së dhunës në familje për periudhën e caktuar, po jo me qenë eliminimi, edhe e ki paragrafin tjetër, arsimimi dhe informimi, atje mundet me qenë parandalimi fenomen i dhunës në familje, përmes procesit edukativ arsimor, tek faqja nr. 7 tek kapitulli nr. 3 analiza situatë dhe problematika e dhunës në familje, ku ke shku te paragrafi dy, p.sh.: pabarazia gjinore në Kosovë, roli I femrës këtu duhet me qenë në Kosovë, dhuna në familje fillon nga familja tek institucioni. Në faqen 8, e keni pabarazia gjinore dhe gjendja ekonomike. Kjo është e pakuptueshme në zhargonin juridik. Këtu mundet me qenë shkallë e ulët e punësimit të gruas dhe ndikimi i saj në pabarazinë gjinore, në paragrafin e dytë e ke cek problem social, që lidhen me dhunën në familje, e ke cek martesat e hershme si problem në dhunën në familje, kur i ke cek vitet 2017-2018-2019, kanë qenë për tri vite vetëm dy raste, nuk mundet me qenë problem nëse I kemi vetëm dy raste. E ki te faqja 11, fushëveprimi, e ke cek eliminimi i pabarazisë gjinore. Këtu ky term duhet mu jek e mu shkur, parandalimi, prapë e ki paragrafin tjetër objektivat. Eliminimi, zvogëlimi edhe i ki tek shtojcat, p.sh.: fusha e veprimi, nën a), e ki bërë eliminimi i pabarazisë gjinore. Edhe ky termë mendoj që duhet mu hek, mu zëvendësu me futja e numrit të rasteve të pabarazisë gjinore të dhunës në familje.

znj.Ibadeter Hyseni: Strategjia e kaluar, d.m.th që ndoshta jo plotësisht, mirëpo është implementu, pasi që shumica e aktiviteteve kanë qenë pako financiare. Sa i përket problemit të rinte grimit të viktimave të dhunës në familje, nuk është problem vetëm lokal, po është problem edhe nacional, dhe këtu duhet me pas mirëkuptim. Sa i përket vërejtjeve të Nuredin Luftiut, strategjia ka qenë në shqyrtim, edhe është hera e dytë që vjen në kuvend, ka qenë diskutim publik. Vërejtjet që i ka pas, ka mujt t'i sjell më herët, pasi që e ka pas strategjinë edhe më herët, po sido që të jetë, ky draft nuk është hartu nga unë po është hartu nga një grup prej profesionistëve, që merren me viktimat e dhunës në familje, duke përfshirë policinë, qendrën për punë sociale, QKMF-në etj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të katër të rendit të ditës kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e draft rregullore për transparencë në Komunën e Vitisë, me kërkesën e MAPL-së.

Këtë rregullore e ka kthy MAPL-ja, për shkak të disa gabimeve teknike tek koha e afateve tek dëgjimet publike. Unë hapi debat për diskutim. Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim për miratim. Nga të gjithë u miratu edhe kjo pikë.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik të planit komunal i menaxhimit të mbeturinave.

Drejtori z.Nexhmedin Jakupi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Po bëhet fjalë për dy dokumente shumë të rëndësishme, që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave. Ne kemi planifikim për muajin prill ta bëjmë këtë propozim vendim, po u shty për shkak të pandemisë, andaj materialin e keni para vete, nuk po e lexoj bazën ligjore po vetëm po propozoj, që datat e debatit publik të jeni prej 01.06.2020 deri me 30.06.2020, të jete koha e diskutimit publik rreth këtij

plani dhe rregullores, ndërsa debatin me qytetar e kemi lënë me datën 01.07.2020, debat me qytetar, e me të interesuar të tjerë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë.

znj.Mirlinda Sadiku: Po kyçem tek mbeturinat. Është zona administrative e Klllokotit, po megjithatë nëse ke komunikim me ta, aty tek cerneli është bë një deponi e madhe. Bisedo me ta, se mundet me paraqit problem, vjen erë shumë e madhe. Nuk e di unë, zyrtarja ligjore paska hecë, e kemi Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, ju jep të drejtë komunave me e themelu një kompani për menaxhim të mbeturinave, duke ja shtu kësaj që sipas asaj që është e publikume në wep zyrtar të Komunës, Komuna e Vitisë e ka një vendim për themelimin e ndërmarrjes publike e quajtur “Natyra”. Kjo ka ndodhë, për ata që nuk e dinë, në kohën kur ka qeverisë zotri Nexhmedin Arifi. Vendimi ka qenë i protokolluar me 15.04.2013, po në të njëjtën ditë është formu edhe komisioni i aksionarëve, edhe në të njëjtën kohë ne si kuvend përderisa nuk e kemi shfuqizu këtë vendim, faktikisht dhe ligjërisht është në fuqi me aq sa kuptoj dhe sa di unë në aspektin ligjor, po tu ja bashkangjijt edhe kësaj, ne si kuvend kemi pas propozu dhe miratu, që zotri Halil Musliu të jetë anëtar i komisionit të aksionarëve, me datën 30.12.2014 në kompaninë “Ekohigjiena”, e cila i mbledh edhe mbeturinat e Komunës së Vitisë, që nga ajo ditë që ka dhënë dorëheqje, na absolut nuk kemi qasje, ani pse është kompani publiko private, ne nuk kemi qasej në informacion. Nëse ka të bëj diçka në lidhje ne si grup i VV-së, kemi shku kemi marr informta të cilat na u kanë dashtë. Unë mendoj që do të ishte mirë të sqaromi, ma merr mendja që do të jetë një sfidë, sepse ka këtu, janë cek që janë 35 deponi, ku mu ma merr mendja që ka hala më shumë. Tu e pa gjendjen në teren, uroj ta jetësoni këtë, po ligjërisht do të ishte mirë të sqarohen këto gjera, që mos të kemi ndeshje dhe masanej të na dalin probleme. Sipas asaj që po e shoh që është shkru, këtu kemi 8 mije e 369 konsumator, mirëpo në sistem janë vetëm 45%, dikun rreth 3700 konsumator, një shifër jashtëzakonisht e ultë, po ajo çka ishte më brengosese, e qe ma merr mendja një nder burimet e mbeturinave e që viktimë jam edhe unë, nganjëherë janë bizneset kogjo shumë prodhojnë mbeturina, edhe kanjëher këtu ishin në menaxhim vetëm 39%. E di që kjo rregullore ka me shku në dëgjim publik, mirëpo do të ishte mirë të sqarohen këto gjëra. Edhe tek neni 6 i rregullores, ndoshta e keni konsultua Zyrën Ligjore, mirëpo neni 6, pika 1 dhe neni 6, pika 1.1, po më dokën kontradikta njëri me tjetrën. Tek e para thotë organi kontraktues i komunës përzgjedh operatorin për me ofru shërbimet për menaxhimin e mbeturinave, d.m.th i përzgjedhë me procedura, ndërsa pika 6, neni thotë: “komuna mund të përzgjedh operator një ndërmarrje me pronësi të komunës, pa ndjek procedurat e tenderimit sipas legjislacionit për prokurim publik”. Mu me tingëllon që këto dy janë në kundërshtim.

z.Njazi Isaku: Sa i përket Ligjit për Mbeturinat, është i vitit 2012 dhe aty tek menaxhimi i mbeturinave, flitet që komuna duhet me e hartu një plan strategjik. Tash viti 2020, më mirë von se kurrë hiq. Edhe kam pa që Komuna ka bë një plan të veprimit, pasi që është për dëgjim publik, na jemi pro.

z.Bekim Azizi: Kjo është një nder pikat më të rëndësishme që e prek drejtpërdrejt qytetarin. Do të kontribuojmë me propozimet e tona edhe tek kjo pikë dhe tek rregullorja. Mendoj që edhe grupet e ndryshme duhet të kontribuojnë me propozimet e tyre dhe deri në fund ta bëjmë një plan dhe një rregullore të mirë. Ne jemi pro këtyre pikave.

z.Nexhmedin Jakupi drejtor: Plani për menaxhimin e mbeturinave e kemi punu me GIZ-in, ndërsa rregulloren zyrtarët tonë, grupa punuese ka vërejtje, lëshime. I kemi vërejtjet, po mendoj që do të përmirësohen. Sa i përket asaj, mbeturinat që e ceku Mirlinda ne Cernel, ndoshta ka qenë më mirë me ja drejtu Drejtorisë së Inspeksionit atë pyetje, se ata kanë të drejtë me operu edhe në Komunën e Klllokoti po edhe ne si koleg bisedojmë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Qes në votim për miratim që të shkon në diskutim publik. Nga të gjithë të pranishmit u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të gjatë të rendit të ditës kemi:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik të rregullores për menaxhimin e mbeturinave

Drejtori z.Nexhmedin Jakupi e prezantoi këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi z.Naim Pira: Qes në votim për miratim edhe këtë pikë. Nga të gjithë të pranishmit u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të shtatë të rendit të ditës kemi:

7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik të planit komunal i veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021.

z.Xhelal Musa, zyrtar i projekteve: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Para jush e kemi propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik të planit komunal i veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021. Ky plan është mbështet nga qeveria Gjermanisë, përmes GIZ-it dhe projektet e Kosovës për eficientë e energjisë dhe qeverisë komunale. Këtë projekt e ka hartuar kompania e licencuar për projekte të tilla, me bashkëpunim me zyrtarin komunal të eficiencës së energjisë. Materialin e kemi pranuar me kohë, për pyetje shitesë jam në dispozicion e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë, pasi që nuk ka të interesuar për pyetje, qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të tetë të rendit të ditës kemi:

8. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit te punës se komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuar për vitin 2020, dhe raportit i punës për vitin 2019

Është komitet që e kemi formuar ne si kuvend dhe vazhdimisht naj sjellin planin dhe raportin, nëse ka dikush me diskutu, nëse nuk ka, e qes në votim për miratim. Nga të gjithë u miratu kjo pike e rendit të ditës.

Si pike të nëntë të rendit të ditës kemi:

9. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit te punës se komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2020

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Bekim Azizi: Në këtë plan po thuhet rialokim, të nxënësve të shkollës “Halil Alidema”. Nuk po e kuptoj këtë në asnjë mënyrë, se që 20 vite sun e kamë gjet asnjë nxënës aty dhe tek plani po e shof që është bazu në përgjithësi në arsim. Nuk është bazu në rini, sport, kulturë, që është e parapame si komision, po krejt janë të lidhura me çështje të arsimit, plani vetëm për arsim janë paraqit do pika të mira, ndërsa pjesën tjetër është i mangët.

znj.Mirlinda Sadiku: Ne jemi fokusu më shumë në arsim. Me plotë të drejtë e ke atë vërejtje, edhe pse kemi të bëjmë edhe me kulturë, rini dhe sport, mirëpo tu e pas parasysh qe drejtoria përkatëse e Kulturës, Rinisë dhe Sportit merret me atë specifikë, pak më shumë na fokusin më të madh ja kemi kushtu arsimit, edhe pse e kemi këtu të parapame edhe turnirët, d.m.th organizimet e turnirëve, ka qenë e planifikuar në muajin Prill, pastaj ka qenë mundësia e themelimit të Muzeut të Qytetit dhe prezantime i gjësendeve të luftës së fundit, d.m.th pastaj e kemi gjendjen e shkollës së parë shqipe, që ka të bëjë me kulturë. Sa i përket rialokimit si komision, nuk kemi mujt me gjet terminologji ma adekuate, urojmë të mbahet premtimi publik, i z.Haliti që në shtator të hapet shkolla qyshe e pash unë, punimet e vrazhda hala nuk ishin përfundu fatkeqësisht, ne nuk e kemi parapa Covidin 19, ka qenë një plan shume ambicioz dhe e kam punu me përkushtim. Jam mundu me dhanë kontribut, uroj që të implementohet ky plan.

z.Remzi Salihu: Këtu në muajin Qershor, tek pika e dytë thotë: “mundësia e ndryshimit të rregullores për sjelljen, disiplinën nëpër shkolla, unë këtu do të kisha thanë jo, mundësia po, veprim konkret në ndryshim të rregullores për

sjelljen dhe disiplinën nëpër shkolla, sepse ajo rregullore të cilën ne e kemi dhe e zbatojmë është shumë e ngathtë. Ka disa masa që parashihen, mirëpo pasi që edhe vet jam anëtar i komisionit disiplinor, atje në shkollë ku punoj, e shof që ato masa më shumë kanë efekt negativ se sa pozitiv. P.sh.: parashihet që nxënësi të largohen tri ditë, ai nxënës që largohet tri ditë për shkak të mungesave apo ku ta di unë, shëtit në kaffene të ndryshme dhe prapë vjen i njëjtë nxënës pas tri dite dhe na shkakton problem të tjera, pra mendoj që duhet të parashihen masa që do të kenë efekte të duhura pozitive e jo të kundërta. Këtë po e thamë nga provoja që e kam këtu, nuk po flas vetëm për nxënës po edhe për mësimdhënësin. Pra të jetë striktë, të dijet kush të përgjigjet, nxënësi apo mësimdhënësi dhe në këtë rregullore të parashihet kontrolle më e madhe, komisioni apo shkolla dhe pastaj drejtoria të ketë mundësi të na kontrollojnë neve pak ma tepër, se a kemi vepru konform rregullorës e ligjit.

z.Ali Bajrami: Mirlindë, mirë që e keni bërë me kryetarin këtë plan të punës. Ajo çka nuk më pëlqen, thave jemi fokusi më tepër në arsim e jo rini, kulturë, se thave drejtori i kulturës është. Nëse është ashtu, atëherë edhe arsimit e ka drejtori që është kompetencë e tij me u marr me këto çështje. Rregulloret e brendshme të shkollave, inicimi i ndryshimit të rregullores komunale për bursa të studenteve dhe mundësia e ndryshimit të rregullores për sjelljen, disiplinën në shkolla. Ka qenë edhe në përbërjen e kalume të kuvendi, menjëherë në 2014 I kemi pas rregulloren në diskutim publik, janë votu në kuvend të gjitha rregulloret të arsimit të ulët, të lartë dhe të mesëm. Janë në harmoni më ligjin e Ministrisë së Arsimit dhe janë rregullore që derivojnë nga Ministria e Arsimit.

znj.Mirlinda Sadiku: Plotësisht ka të drejt profa, që tha për mundësi e kemi lanë si terminologjinë, mundësi për arsye, se me ndryshu rregulloren, neve sipas rregullores së kuvendi na duhet me se paku 8 nënshkrime për me e inicic ndryshimin e rregullores, e tani a naj japin të tjerët nënshkrimet apo jo. Tash varet, është si mundësi, nuk kemi muj me thanë që është definitive. Sa i përket rregullores për bursa, qe është aprovu në muajin maj të vitin 2014, drejtor ka qenë, z.Qahil Sinani. Kam qenë ndër të vetmet që kam votu kundër. Shikoj procesverbalet e thamë me përgjegjësi, sepse sipas rregullores dhe me kujtohet shume kuart çka i kam thanë drejtori, shumë më mirë koke mendu dhe paske perpili rregulloren qyshe me I dënu mësueset, se sa me i shpërbly për punën e mirë që e bëjnë dhe plotësisht ka të drejt profesori Remzi, se kërkush nuk e dinë më mirë problematiken në shkolla, se sa ne që jemi në arsim. Prandaj unë kam qenë kundër asaj rregullore dhe prapë jam kundër dhe ma merr mendja që ka nevojë për përmirësime dhe do ta japim kontributin edhe atëherë.

z.Ali Bajrami: Nuk kam nevojë mu bë avokat i profës Qahil. Çdo respekt për ta, rregulloret që kanë ardh prej Drejtorisë së Arsimit, kanë qenë rregullore të nxjerra prej ligjit të Ministrisë së Arsimit. Nuk kanë qenë të nxjerra prej drejtorisë komunale as prej Qahilit. Ato rregullore janë të bazuara në ligj, prandaj po thamë, e ti nëse je kanë kundër asaj rregullore, je kanë kundër ligjit.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Unë mendoj që duke filluar prej stafit menagjues prej DKA-së dhe dy drejtorë që I kemi në shkolla të mesme dhe drejtorat e shkollave të tjera, në rast që e shohin se një rregullore në implementim sjell problem tek mësimdhënia, nuk do t'i presim tetë nënshkrime. Ajo iniciativë mundet me grumbullu nga ajo rregullore, e hinë ndryshimit duke u bazuar konformë të ligjit, po duke qenë rregullorja me e kuartësuar, neve nuk na prish punë, ajo asnjë problem nuk do ta kemi. Ku është të kemi rregullore të mire për menaxherin që punon, mësimdhënësin e nxënësit.

Kryesiesu z.Naim Pira: Qes në votim për miratim këtë pike të rendit të ditës. Nga të gjithë u miratu edhe kjo pikë. Ju falënderoj për kontributin që keni dhënë, mirupafshim në seancën e ardhshme.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 13:20 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira
